



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 1131 Prot.

Tiranë, më 30.12:2019

UDHËZIM

Nr. 30, datë 30.12.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 03.08.2016 “PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 6 të nenit 92, të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

1. Në udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - a) Pika 1, e Kreut II, ndryshon si më poshtë:

*“1. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare apo Evropiane të Kualifikimeve, si dhe të titujve akademikë kryhet vetëm online nëpërmjet portalit e-albania. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar duhet të depozitohet detyrimisht i skanuar gjatë aplikimit online.”*
  - b) Pika 1, e Kreut III, ndryshon si më poshtë:

*“1. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave universitare të nivelit 5 deri në nivelin 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK), kryhet online sipas procedurës së mëposhtme:*

    - a. *formulari i aplikimit plotësohet online në portalin e-albania. Këtij formulari i ngarkohet në format elektronik (PDF), dokumentacioni i parashikuar në germat b), c), d) dhe e) të kësaj pike.*
    - b. *diploma/certifikata, ose dokumenti zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, kopje e njësuar me origjinalin, si dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës;*
    - c. *lista e notave dhe/ose suplementi i diplomës (nëse ka), të njësuar me origjinalin, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës;*

